

UDHËZIM
Nr.34, datë 27.10.2008

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR PAJISJEN ME LEJEDREJTIMI

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, Ministri i Financave dhe Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit

UDHËZOJNË:

1. Tarifa e pajisjes me lejedrejtimi për drejtimin e automjeteve është si më poshtë:
 - a) për lejedrejtimi të kategorisë A 3 000 (tre mijë) lekë;
 - b) për lejedrejtimi të kategorisë B 4 500 (katërmijë e pesëqind) lekë;
 - c) për lejedrejtimi të kategorisë C 2 000 (dy mijë) lekë;
 - ç) për lejedrejtimi të kategorisë D 3 000 (tre mijë) lekë;
 - d) për lejedrejtimi të kategorive BE, CE dhe DE 3 000 (tre mijë) lekë.
2. Për vjeljen e tarifës për pajisjen me lejedrejtimi për drejtim automjeti ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.
3. Detyrimi i pagimit të kësaj tarife lind në momentin e dhënies së dëshmisë së aftësisë për drejtim automjeti.
4. Shtetasi duhet të pajiset me dokumentin që vërteton pagimin e kësaj tarife. Të gjitha pagesat e tarifës do të regjistrohen në një regjistër të veçantë sipas shtojcës nr.1, bashkëngjitur këtij udhëzimi dhe që është pjesë përbërëse e tij.
5. Për shërbimin e kryer, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor përfiton 5% komision të llogaritur mbi masën e tarifave që ka arkëtuar dhe ka transferuar në Buxhetin e Shtetit.
6. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT DHE
TELEKOMUNIKACIONIT
Sokol Olldashi

SHTOJCA NR.1
REGJISTRI DITOR I TARIFËS SË PAJISJES ME LEJEDREJTIMI
PËR DREJTIM AUTOMJETI

Nr.	Emër, mbiemër	Lloji i lejes së drejtimit	Masa e tarifës	Nr.i mandatarkëtimit

Drejtoria rajonale e transportit rrugor